



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E MALISHEVËS

Zyra e Personelit

Më:31/08/2023

ACCEPTED ON: 31-08-2023
PRIMLJENO 01 / MS2
Nr. Nr. Rr.

Në bazë të nenit 67 dhe 68, të Ligjit për Zyrtarët Publikë Nr. 06/L-114 dhe Ligjit Nr. 03/L-212 i Punës, Komuna e Malishevës shpall:

SHPALLJE E REKRUTIMIT

Titulli i vendit të punës:	Roje Pylli
Institucioni:	Komuna e Malishevës
Departamenti/ Drejtoria:	Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural
Numri i pozitave:	(2) Dy
Titulli i mbikëqyrësit:	Udhëheqësi i sektorit të Pylltarisë
Grada/Koeficienti:	GJ51 / 3.76
Lloji i emërimit:	I karrierës

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Merr detyra nga udhëheqësi i sektorit të pylltarisë dhe nga tekniku i pylltarisë
- Ruan pyjet nga prerja ilegale, nga zjarret dhe dëmtimet tjera. - ruan florën dhe faunën e pyjeve - bënë vulosjen e drurëve të prerë,
- Jep fletë përcjellëse për transportin e druve të vulosura dhe të prera legalisht,
- Shkruan fletëparaqitje dhe i paditë në gjykatat përkatëse personat që bëjnë dëmtimin e pyllit,
- I raporton teknikut për pylltari dhe udhëheqësit të pylltarisë,
- Paraqet raporte pune mujore, periodike dhe vjetore - kryen edhe punë tjera të caktuara sipas kërkesës së eprorit që janë në pajtim me ligjin.

Shkathtësitë e kërkuara (kualifikime, përvojat si dhe aftësitë dhe shkathtësitë tjera që kërkohen për këtë vend pune):

- Shkolla e Mesme,

Zbatohet periudha provuese në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve konform nenit 70, paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të LZP nr.06/L-114.

Çdo kandidat (aplikues) për pozitën e lartcekur duhet t'i kompletoj dhe dorëzoj dokumentacionin e domosdoshëm (fotokopje) si vijon:

1. Dëshmi të kualifikimit shkollorë, fotokopje e noterizuar ose vërtetuar;
2. Dëshmi mbi përvojën e punës ;
3. Dokumentin e identifikimit ;
4. Certifikatën se nuk është nën hetime dhe nuk është i dënuar për ndonjë vepër penale;

5. Certifikatën mjekësore (Për shkak të minimizimit të shpenzimeve të kandidatëve pjesëmarrës në konkurs, në fund të procedurës rekrutuese e njëjta do të kërkohet vetëm nga kandidati më i suksesshëm)

Konkursi mbetet vetëm njoftim 30 ditë nga data e publikimit, ndërsa konkursi shpallet i hapur për aplikim dhe dorëzimin e dokumenteve 8 ditë nga data 01.10.2023 deri me 09.10.2023.

Paraqitja e kërkesave: Aplikacionet merren dhe të plotësuara dorëzohen në zyrë për pritjen e palëve të Komunës së Malishevës, përkatësisht në zyrën për shërbim të qytetarëve.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, kurse ato të mángëta refuzohen.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër do të njoftohen për vendin, datën dhe kohën e mbajtjes së testimit me shkrim përmes Web faqes zyrtare të komunës dhe tabelës së shpalljeve publike të Komunës.



Gani Bahtjaraj jur.dip
Menaxher i Personelit